



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

V E N D I M

Projekt

PËR

**PAGESËN E KOSTOS FINANCIARE TË SISTEMIT TË IDENTIFIKIMIT DHE
REGJISTRIMIT TË KAFSHËVE DHE FERMAVE BLEGTORALE NGA FERMERËT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 7 të ligjit nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” me propozim të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kafshët dhe fermat blegtorale identifikohen dhe regjistrohen sipas sistemit kombëtar të identifikimit dhe regjistrimit (IR) të mbajtur nga autoriteti kompetent, që është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e këtij sistemi.
2. Të gjitha termat e përcaktuara në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” kanë të njëjtën kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa me termat e më poshtëme kuptohet:
 - a) “Fond kundërparti” është fondi i krijuar nga pagesa e fermerëve për bazën materiale të sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve i cili përdoret për blerjen në vazhdimësi të materialeve për funksionimin e këtij sistemi.
 - b) “Fermer” është çdo person fizik apo juridik që ka në pronësi kafshët.
 - c) “Bazë materiale për procesin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve dhe fermave blegtorale”, janë matrikujt për matrikullimin e kafshëve, regjistrat, pasaportat, kartelat, dhe formularët për regjistrimin e kafshëve.
 - d) “Operator privat” është personi fizik ose juridik i kontraktuar nga autoriteti kompetent sipas procedurave të prokurimit publik në fuqi, për zbatimin në terren të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve.
3. Fermerët të paguajnë pjesën e kostos financiare për sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve dhe fermave blegtorale, që lidhet me pagesën e vlerës së bazës materiale për

identifikimin dhe regjistrimin e kafshë si dhe shërbimin e kryer nga operatorët privatë për vendosjen e matrikujve duke filluar nga muaji Janar i vitit 2017.

4. Fermerët për shërbimin e ofruar për matrikullimin e kafshëve kryejnë pagesën e dokumentuar financiarisht drejtëpërdrejtë tek operatori privat i kontraktuar.

5. Vlerat për pagesat sipas pikës 3 dhe 4 të këtij vendimi përcaktohen bazuar si më poshtë:

a) Pagesa për bazën materiale të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve që bazohet në koston e çmimit të bazës materiale të realizuar nga ministria, nëpërmjet procedurës së prokurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

b) Pagesa e shërbimit për vendosjen e matrikujve dhe plotësimin e formularit përkatës nga operatori, që bazohet në tarifën e miratuara me udhëzimin të përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për financat.

6. Pagesa nga fermerët për bazën materiale të sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve dhe fermave blegtorale e kryer në çastin e matrikullimit të kafshës, sipas pikës 3 të këtij vendimi depozitet e dokumentuar financiarisht nga operatori privat në llogarinë e ministrisë.

7. Pagesa për shërbimin e vendosjes së matrikujve i paguhet drejtëpërdrejtë operatorit privat nga fermeri.

8. Vlera financiare e depozituar nga operatori privat në llogarinë e ministrisë shërben për krijimin e fondit kundërparti.

9. Fondi kundërparti të përdoret për blerjen në vazhdimësi të bazës materiale të sistemit të identifikimit, regjistrimit të kafshëve dhe fermave blegtorale, bazuar në urdhërin e ministrit.

10. Blerja e bazës materiale për sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve dhe fermave blegtorale nga fondit kundërparti bëhet në bazë të procedurave të prokurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

11. Ministria për vitin 2016, që nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të sigurojë bazën materiale për identifikimin dhe regjistrimin e të gjithë kategorive të kafshëve të llojit gjedh dhe të imta që mbarështohen në të gjithë territorin e vendit.

12. Vendimi nr. 320, datë 19.3.2008 i Këshillit të Ministrave, “Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale” shfuqizohet.

13. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi ministria.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA